

# KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA – “KNRP”



## STATUTI

PRIZREN  
Janar, 2014

## **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

Me këtë Statut, Kosovaki Nevi Romani Partia (në tekstin e mëtejme KNRP) përcakton dhe rregullon emrin, emblemën dhe selinë, përfaqësimin, anëtarësinë, të drejtat dhe përgjegjësitë, format e organizimit dhe të veprimit, procedura për zgjedhje, forumet e saj, administratën, financimin, kushtet për ndërprerjen e veprimtarisë, si dhe çështjet e tjera me interes për anëtarët e saj.

### **Neni 2**

2.1 Kosoavki Nevi Romani Partia , është parti politike e Romëve të Kosovës e cila organizohet si forcë politike për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të popullates Rome në Kosovë.

2.2 Partia angazhohet për bashkimin e të gjithë Romëve me qëllim të krijimit të një force kompakte, frytëdhënëse në drejtim të mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut dhe mbrojtjen e Kosovës si vendlindje e tyre.

2.3 Kosovaki Nevi Romani Partia, ka ambicie per bashkpunim me te gjitha subjektet politike për veprim të koordinuar të popullit Rom në Kosovë.

### **Neni 3**

Kosovaki Nevi Romani Partia, është parti politike e qendrës së djathtë, e anëtarëve të lirë dhe të përgjegjshëm, të cilët veprojnë mbi baza të Statutit, për të arritur objektivat e përcaktuara në Programin e saj politik.

### **Neni 4**

Pranë partisë mund të kyqën të gjithë qytetarët pa dallim kombi, race, gjinie apo përkatesie fetare.

### **Neni 5**

5.1 Kosovaki Nevi Romani Partia (5) -ja vepron në mënyrë të pavarur dhe publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

5.2 Puna dhe veprimtaria e parties KNRP-së jasht Kosoves ushtrohet ne bazë te ligjeve ne fuqi , në shtetin ku vepron kjo degë e KNRP-së

## **SELIA, VULA DHE EMBLEMA**

### **Neni 6**

6.1 Selia e Kosovaki Nevi Romani Partia është në Prizren.

6.2 Kosovaki Nevi Romani Partia ka logon, vulen dhe akronimin e saj.

6.3 Emblema e partisë në vete përmbanë hartën e Kosovës e ndarë në dy ngjyra të flamurit ROM ne menyre horizontale (gjelbërt dhe kaltërt) , në mes të hartës gjindët rrota e cila përcakton simbolin e Romëve si dhe rrëth hartës përmban dymbëdhjet yje të cilët simbolizon europen dhe lirin.

6.3 Vula e partisë përmbanë përshkrimin e plotë të emblemës së partisë, nga përshkrimi I nenit 6 të paragrafit 6.2.

## **ANËTARËSIA**

### **Neni 7**

7.1 Ne Kosovaki Nevi Romani partia mund ti bashkohet cdo person I moshes madhore, I cili ka shprehur deshiren per tu bashkuar statutit dhe programit te KNRP-se.

7.2 Anëtarësimi bëhet me deklaram të lirë, në formë të shkruar, në qendrën e parties.

7.3 Anëtarët e KNRP-së paguajnë anëtarësinë prej 6 euro Brenda nje viti kalendarik.

7.4 Evidencen mbi antarësin e regjistrimit të KNRP-së e mbajnë degët e KNRP-së dhe Kryesis se saj. Mbajtja e regjistrit dhe mënyra e lëshimit të kartelave për anëtarësinë rregullohet me rregullore të Veçantë.

7.5 Anetaret kanë të drejte per informim per te gjitha te hyrat dhe shpenzimet financiare duke kerkuar nga Këshilli I pergjithshëm që ti raportoj Kuvendit mbi menyren e shpenzimit dhe financimit te parties KNRP-se

## **DETYRAT DHE TË DREJTAT E ANËTARIT TË KNRP-së**

### **Neni 8**

8.1 Anëtari i Kosvaki Nevi Romani Partia ka për detyrë:

- Të zbatojë Programin, Statutin dhe vendimet e organeve udhëheqëse të KNRP-së;
- Të ruajë bashkimin dhe unitetin e radhëve të KNRP-së;

- Të bëjë pjesë në një këshill të KNRP-së ;
- Të paguajë rregullisht kuotën e anëtarësisë;
- Të mos bëjë pjesë në parti dhe organizata të tjera politike brenda ose jashtë vendit;
- Të mos kandidohet si i pavarur ose për forcat e tjera politike dhe as të kontribuojë në favor të tyre në fushatat zgjedhore;
- Të respektojë disiplinën e organizatës dhe të kontribuojë për forcimin e kohezionit të saj;
- Të punojë për rritjen e ndikimit të KNRP-së, në komunitetin përkatës dhe për shtimin me anëtarë të rinj të radhëve të saj.

## 8.2 Anëtari i KNRP-së ka të drejtë

- Të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të organizimit, të vijës politike dhe të punëve e detyrave që organizata ia ka parashtruar .
- Të jetë i informuar dhe të bëjë pyetje, kritikë, kërkesë, njoftim, propozim e ankesë në të gjitha instancat e KNRP-së;
- Të zgjedhë dhe të zgjedhet në organet e KNRP-së;
- Të propozojë dhe të propozohet kandidat - përfaqësues i KNRP-së, në organet e shtetit legjislativ dhe ekzekutiv;
- Të njihet me veprimtarinë e përfaqësuesve të KNRP-së në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv e të bëjë vlerësime për punën e tyre;
- Të mbrohet nga KNRP-ja kur ai sulmohet dhe persekutohet për bindjet e tij politike;
- Të ruajë nderin, autoritetin dhe interesat e KNRP-së;

## **NDËRPRERJA E PËRKOSSHME E ANËTARËSISË DHE LARGIMI NGA KNRP-ja**

### **Neni 9**

9.1 Anëtari i Kosovaki Nevi Romani Partia mund të kritikohet, t'i tërhiqet vërejtja, të pezullohet ose të përjashtohet kur shkel normat e Programit e të Statutit të partise.

9.2 Ndaj anëtarit të Kosvaki Nevi Romani Partia që shkel vendimet e forumeve të saj ; cenon normat shoqërore, që burojnë nga Programi dhe Statuti i KNRP-së ; nuk paguan kuotën e anëtarësisë ; mungon pa arsye në mbledhjen e këshillit ose në organet ku është zgjedhur për më shumë se 3 muaj dhe me veprimin e tij nuk justifikon qenien në KNRP ose në organet e saj drejtuese, sipas shkallës së përgjegjësisë, merren këto masa:

- Këshillim ;
- Vrejtje;
- Shkarkim nga organet e zgjedhura të KNRP-së;
- Çregjistrim nga KNRP-ja;
- Heqje e mbështetjes politike për mandatin e marrë.

9.3 Shqiptimin e masave e bën këshilli ose organi në të cilin bën pjesë anëtari, ose me propozim të një organi drejtues. Ai hyn në fuqi pasi të miratohet nga Kryesia e Këshillit Përgjithsëm . Shkarkimi nga detyra dhe çregjistrimi nga KNRP-ja i anëtarit të Këshillit Ekzekutiv ose të Këshillit të

Përgjithshëm të KNRP-së, vendoset nga organi ku ai është zgjedhu, ne qendër te partis.

9.4 Anëtari ndaj të cilit merren masat statutare, ka të drejtë ankese . Ankesa paraqitet në organin, që ka shqiptuar masën, Keshilli Pergjithshem.

9.5 Heqjen e dënimit e bën organi që e ka shqiptuar dënimin.

9.6 Të gjitha masat e shqiptuara do të jenë të paraqitura me shkrim.

## **Neni 10**

Anëtari i KNRP-së, i cili jep dorëheqje me shkrim, nga anëtarësia, duhet të informojë për këtë Kryesinë e nenedeges ,degës dhe kryesinë e partisë. Me kërkesën e tij, mund t'i lëshohet vendimi me shkrim nga Këshilli i Përgjithshëm.

## **ORGANIZIMI DHE ORGANET E KNRP-SË**

### **Neni 11**

11.1 KNRP-ja organizohet në Degë dhe Nëndegë, si ne Kosove ashtu edhe jasht territorit administrative të Kosovës.

11.2 Kosovaki Nevi Romani Partia bashkëpunon me anëtarët, përkrahësit dhe simpatizantët e vet ne vend si dhe jashtë territorit të Kosovës, me organizatat qeveritare dhe joqeveritare, subjektet politike, asociacione te ndyshme rome dhe jo-rome te themelura në pajtim me rendin juridik të atyre shteteve.

11.3 KNRP do te bashkpunoje edhe me organet relevante te Keshillit te Europes dhe Bashksisë Europiane si dhe me abasadat në vend dhe jasht vendit.

11.4 Kosovaki Nevi Romani Partia mund të bashkëpunojë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare politike të cilat kane aspirate te ngjashme programore .

## **ORGANET E KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA**

### **Neni 12**

12.1 Organet e Kosovaki Nevi Romani Partia janë:

1. Kuvendi
2. Këshilli i Përgjithshëm
- 3.Kryesia
- 4 Këshilli Mbikqyrës

## **Kuvendi i KNRP-së**

### **Neni 13**

13.1 Kuvendi është organi më i lartë i KNRP-së.

13.2 Në Kuvend marrin pjesë delegatët nga deget komunale, të formuara së paku, dy muaj para Kuvendit. Ne kuvend marrin pjesë antarët e keshillit të përgjithshëm të partisë dhe shoqatat përkrahse të partisë së vendit dhe jashtë teritorit administrativ të Kosovës.

13.3 Numri i delegateve në kuvend përcaktohet sipas kuotes së banorve në komunat gjegjëse (0-300 banorë, një delegate.)

13.4 Në punën e Kuvendit mund të jenë të ftuar si dhe të marrin pjesë përfaqësuesit të organeve shtetërore, institucionet ndërkombëtare si dhe antarët e partive tjera politike, fondacionet si dhe mysafiret tjere, por pa të drejtë vote.

13.5 Në punën e Kuvendit mund të emrohet edhe mysafir nderi ata persona të cilët në mënyrë indirekte apo direkte kanë kontribuar për komunitetin Rom në Kosovë, me titull "Romano/i Phrall/Phen" (Vllau/Motra Rom/e), sipas rregullores së KNRP-së.

13.6 Të gjithë delegatët e ftuar në Kuvend kanë të drejtë vote.

13.7 Kuvendin e hap delegati më i vjetër i pranishëm.

13.8 Në Kuvend marrin pjesë forumi i Gruas dhe forumi Rinor.

13.9 Delegatët kanë mandat katër vjeçar dhe thirren sipas nevojës nga Këshilli i Përgjithshëm i KNRP-së.

13.10 Delegatët për në Kuvendin e punës të KNRP-së zgjedhen nga Degët dhe Nendegët të KNRP-së. Normat e përfaqësimit vendosen përmes rregullores së partisë KNRP.

13.11 Kuvendi i Kosovës Nevi Romani Partia mbahet një herë në katër vjet. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të thirret nga Këshilli i Përgjithshëm, ose me kërkesën e një të tretës (1/3) të delegateve të Kuvendit.

13.12 Thirrja dhe rendi i ditës për Kuvend bëhet, së paku, një muaj para mbajtjes së tij.

### **Detyrat e Kuvendit**

### **Neni 14**

14.1 Kuvendi shqyrton dhe miraton raportin e Këshillit të Përgjithshëm dhe raportet e tjera të organeve e komisioneve të KNRP-së përmes Këshillit të Përgjithshëm; përcakton vijën politike të organizative të KNRP-së dhe detyrat e saj deri në mbledhjen tjetër të Kuvendit; zgjedh Këshillin e Përgjithshëm, Kryesin e Këshillit të Përgjithshëm, zgjedh kryetarin e KNRP-së me vota të fshehta me më

shumë kandidatë, Këshillin Mbikëqyrës prej 5 anëtarësh , miraton Programin, Statutin, Rregulloren e Punës dhe akte të tjera .

Numri i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm përcaktohet nga Kuvendi. Kryetarët e Këshillave të Degës, Kryetari i të Rinjve të KNRP-së, dhe Kryetarja e Forumit të Gruas të KNRP-së, bëhen drejtpërdrejt anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të KNRP-së.

14.2 Numri i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të zgjedhur drejtpërdrejt nuk guxon të kalojë 1/3 e anëtarësisë së plotë të Këshillit të Përgjithshëm.

14.3 Kuvendi udhëhiqet nga Kryesia e Përgjithshme.

14.4 Këshilli i Përgjithshëm zgjedh kryesinë e tij dhe sekretarin e përgjithshëm të partisë.

14.5 Numrin e nënkryetarve dhe funksionet përkatëse përcaktohen përmes degëve Regjionale.

14.6 Kuvendi vendos për shpërndarjen e KNRP-së apo për bashkimin e KNRP-së, me subjektet dhe partitë tjera politike.

## **KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I KNRP-së**

### **Neni 15**

15.1 Këshilli i Përgjithshëm (KP) udhëheq punën politiko-organizative ndërmjet dy Mbledhjeve të Përgjithshme të KNRP-së. Në rast nevoje, formon komisione të veçanta me ekspert të lemise përkatse të cilët mund të jenë edhe të përkatsisë jo rome.

15.2 Merr qëndrime e vendime të karakterit tekniko-organizativ, shqyrton propozime, ankesa dhe sygjerime.

15.3 Këshilli i Përzgjidhshëm e zgjedh Liderin Politik të Kosovaki Nevi Romani Partia, i cili do të jetë edhe bartës i listes në zgjedhjet nacionale për katër vjet.

15.4 Lideri Politik do të zgjidhët sipas rregullores së punës të Kosovaki Nevi Romani Partia, në të cilën do të përcaktohen edhe kompetencat, funksionet dhe detyrat e tij.

15.5 Miraton dhe kontrollon shpërndarjen e mjeteve materiale e financiare të KNRP-së

15.6 Këshilli i Përgjithshëm përbëhet prej shtatë (7) antarëve të kryeis, pesë (5) antarëve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe nga kryetarja e forumit të Gruas dhe forumit Rrinor si dhe përfaqësues të degëve.

15.7 Këshilli Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet Kuvendit.

15.8 Këshilli Përgjithshëm i zhvillon punimet e tij në bazë të rregullores së Këshillit të Përgjithshëm, e cila hartohet nga Kryesia e tij dhe miratohet nga Këshilli i Përgjithshëm i KNRP-së.

15.9 Këshilli Përgjithshëm vendos për hyrjen e KNRP-së, në koalicion elektoral me subjektet dhe partitë tjera politike.

15.10 Këshilli i Përgjithshëm i KNRP-së, mbledhet jo më rrallë se 3 here në vit , me kërkesën e Kryesisë, të Kryetarit të KNRP-së, ose jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij.

15.11 Sipas rregullores së punës të Këshillit Përgjithshëm, ai zgjedhë antarët e Këshillit Ekzekutiv dhe Këshillin Mbikqyrës.

15.12 Sipas rregullores të Këshillit Përgjithshëm, Kryesia zgjedhë antarët e Këshillit Mbikqyrës.

15.13 Pranë Këshillit të Përgjithshëm të KNRP-së, dhe Këshillave Drejtuese të Degëve, sipas mundësisë financiare krijohen aparate politike e administrative, veprimtaria e të cilave ka karakter konsultativ dhe teknik.

15.14 Kuvendin Zgjedhor kanë drejt ta thasin 1/3 të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm.

## **KRYESIA E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM**

### **Neni 16**

16.1 Kryesia është organ ekzekutiv i Këshillit të Përgjithshëm , e cila, në bazë të orientimeve e vendimeve të Kuvendit dhe të Këshillit Përgjithshëm, përcakton I konkretizon detyrat që dalin prej tyre. Kryesia thërret e drejton mbledhjet e KP-së, paraqet raporte dhe i përgjigjet atij.

### **Detyrat e Kryesisë**

### **Neni 17**

- Zbaton vendimet e organeve drejtuese qendrore (Kuvendin dhe Këshillit të Përgjithshëm të KNRP-së)
  - Përpunon qëndrimet politike aktuale dhe organizon e drejton veprimtarinë e përgjithshme të KNRP-së.
  - Ndihmon dhe kontrollon organet drejtuese të KNRP-së në dege , për zbatimin e vendimeve të organeve qendrore ( Kuvendit dhe, Këshillit të Përgjithshëm).
  - Vendos për strukturën e aparatit politik e administrativ të Këshillit të Përgjithshëm, të institucioneve të tjera qendrore të KNRP-së dhe të Këshillave të degëve.
  - Nxjerr udhëzime në përputhje me Statutin e KNRP-së, dhe në zbatim të vendimeve që merren në Kuvend , dhe në Mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të KNRP-së.
  - Mund të propozojë në Kuvendin e Këshillit të Degës kandidaturë për kryetarin e Këshillit të Degëve të KNRP-së në Degë.
  - Ka të drejtën e pezullimit të vendimit të Kryesisë së Këshillit Drejtues së Degës, kur ai bie ndesh me Statutin dhe Programin e KNRP-së dhe vendos rishqyrtimin e vendimeve të marrura ose shqyrtimin e problemeve në mbledhje të Degëve . Nëse forumet vendore të KNRP -së, vendosin ndryshe, Kryesia e KNRP-së merr vendimet përkatëse.
  - Propozon kandidatët për kryetarë të komisioneve dhe të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Kosovës dhe ia paraqet për votim Grupit Parlamentar të KNRP -së.
- Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike e financiare dhe I raporton Këshillit të Përgjithshëm.



- Mund të sugjerojë pranë Këshillit të Degës të KNRP-së në zëvendësimin e kryetarit ose të drejtuesve të tjerë të KNRP-së të Degës , për dobësi të theksuara në punë ose për arsye të tjera të argumentuara.
- Kryesia e partisë, në frymën e normave të këtij Statuti dhe për të organizuar funksionimin e saj në ekipe, përcakton ndarjen e punëve e të përgjegjësive për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe nenkryetarët , që ndjekin zbatimin e përditshëm të detyrave, dhe për anëtarët e tjerë të saj. Ky organizim përcaktohet në rregulloren e brendshme dhe për të informohet Këshilli i Përgjithshëm i KNRP-së.
- Kryesia e partisë -së mbledhet jo më rrallë se një herë në muaj.

## **KËSHILLI MBIKËQYRËS**

### **Neni 18**

18.1 Këshilli i Mbikëqyrës perbeht prej pesë (5) anëtarve të zgjedhur nga Këshilli Përgjithshëm , të cilat kanë përvojë pune të pandërprerë në emancipimin dhe integrimin e pjestarve të komunitetit Rom të Kosovës dhe më gjërë në kohëzgjatje se paku tetë (8) vjet.

18.2 Këshilli Mbikëqyrës kontrollon rregullsinë e funksionimit sipas Statutit të organeve ekzekutive të KNRP -së dhe bën zgjidhjen e kontesteve brenda KNRP-së, lidhur me interpretimin e Statutit.

18.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve qendrore të KNRP-së.

18.4 Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të rishqyrtojë vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të KNRP-së,

## **Kryetari i KNRP - së dhe kompetencat kryesore të tij**

### **Neni 19**

19.1 Kryetari i Kosovaki Nevi Romani Partia është drejtuesi kryesor, i cili është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë së përditshme të KNRP-së në zbatimin e vijës politike të përcaktuar nga Kuvendi dhe organet drejtuese të KNRP-së, të Statutit dhe rregulloreve të ndryshme.

19.2 Ka të drejtën e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të Kryesisë së KNRP-së, në Këshillin e Përgjithshëm të KNRP-së, kur e gjykon të nevojshme.

Kryetari i KNRP-së ka këto kompetenca kryesore:

- Thërret dhe drejton mbledhjen e Kryesisë së Përgjithshme;
- Koordinon dhe drejton punën e nënkryetarve të KNRP-së;
- Propozon në Kryesi masa të veçanta në zbatim të Statutit;
- Mban mbledhje të rregullta së paku një herë në muaj, në rast të nevojës takohen edhe para muajit me kryetarë të Këshillave të degëve të KNRP-së.

19.3 Në mungesë të kryetarit kompetencat e tij kalojnë te nenkryetari i parë, apo te nenkryetarët e autorizuar nga Kryetari i partisë.

19.4 Nënkyetarët drejtojnë sektorët të caktuara të veprimtarisë së përditshme të KNRP-së.

## **SEKRETARI PËRGJITHSHËM DHE NENKRYTARET E PARTISE KNRP**

### **Neni 20**

20.1 Sekretari Përgjithshëm ka për detyrë koordinimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Përgjithshëm të KNRP -së, pregatitjen e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm, si dhe ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve të detyrave të Këshillit të Përgjithshëm.

20.2 Sekretari Përgjithshëm mban evidencen e administratës dhe financiare për partinë.

20.3 Sekretari Përgjithshëm organizon takimet të degëve.

20.4 Sekretari Përgjithshëm nënshkruan dokumentet operative financiare;

20.5 Sekretari Përgjithshëm kujdeset për përdorimin e vulave për të gjitha nivelet organizative;

20.6 Sekretari Përgjithshëm përcjell pagesat e anëtarësisë dhe për këtë i raporton Kryesisë së KNRP-së;

20.7 Sekretari Përgjithshëm organizon dhe bashkërendit punën e degëve të KNRP-së dhe për këtë i raporton Kryetarit dhe Kryesisë së KNRP-së;

## **FORUMET ,KESHILLAT DHE GRUPET E INTERESIT**

### **Neni 21**

21.1 Kosovaki Nevi Romani Partia vepron në fusha të caktuara nëpërmjet forumeve, këshillave dhe grupeve të interesit.

21.2 Forumet dhe këshillat e KNRP-së janë:

- Forumi i Gruas së KNRP-së,
- Forumi Rinor i KNRP-së,
- Këshilli i Ekspertëve i KNRP-së.

21.3 Forumet e KNRP-së afirmojnë dhe realizojnë politikën e partisë në fushat në të cilat veprojnë dhe u ndihmojnë organeve të KNRP-së për krijimin e politikave të qëndrueshme.

21.4 Në Forumin Rinor të KNRP-së organizohen të rinjtë nga moshën 16 deri në moshën 30-vjeçare.

21.5 Organizimi dhe zgjedhjet në forumet dhe këshillat e KNRP-së bëhet me rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga Kryesia e KNRP -së.

21.6 Këshilli i Ekspertëve i KNRP-së përbëhet nga krijues shkencorë, arsimorë, kulturorë dhe profesionalë.

21.7 Këshilli i Ekspertëve i KNRP-së zhvillon dhe propozon programe, projekte dhe qëndrime politike për organet e KNRP-së, të cilat pasi të aprovohen nga këto organe bëhen qëndrime zyrtare të KNRP-së. Me aprovim të Kryesisë Ekzekutive i adresohet opinionit.

## **Organizimi në nivel të degëve dhe të nëndegëve të KNRP-së**

### **Neni 22**

22.1 KNRP-ja në terren organizohet në dy nivele, në:

- Degë të KNRP-së dhe
- Nëndegë të KNRP-së.

### **Neni 23**

23.1 Degët dhe nëndegët e KNRP-së janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial të KNRP-së.

23.2 Degët e KNRP-së janë njësi të organizimit në nivel të komunës, sipas ndarjes territoriale administrative të Republikës së Kosovës.

23.3 Degët e KNRP -së mund të themelohen edhe nëpër vendbanime të caktuara me vendim dhe me propozim të Kryesisë.

23.4 Degët e KNRP-së jashtë vendit, krahas respektimit të Programit dhe Statutit të KNRP -së, duhet të respektojnë edhe legjislacionin e vendit përkatës.

### **Neni 24**

24.1 Organet e Degës së KNRP-së janë:

- Kuvendi I Degës
- Kryetari dhe
- Kryesia e Degës.

24.2 Kryesia e Degës përbëhet nga delegate të zgjedhur në kuvendet e nëndegëve dhe përfaqësuesit e forumeve, nëse ato janë të organizuara.

24.3 Kuvendi i Degës së KNRP-së, në përputhje me Programin dhe Statutin e KNRP-së:

- Nxjerr Programin e Punës së Degës;
- Shqyrton dhe miraton Raportin e Punës së Kryesisë;
- Zgjedh Kryetarin e Degës dhe Kryesinë;
- Zgjedh delegatët për Kuvendin e KNRP-së.

## **Neni 25**

25.1 Kuvendi Zgjedhor i Degës mbahet çdo 4 vjet dhe i paraprin Kuvendit Zgjedhor të KNRP-se.

25.2 Ndërmjet kuvendeve të rregullta zgjedhore, mbahen kuvendet e punës, së paku një herë.

25.3 Kuvendi i Degës thirret edhe atëherë kur këtë e kërkojnë 1/3 (një e treta) e delegatëve që e përbëjnë Kuvendin.

## **Kryetari i Degës**

## **Neni 26**

26.1 Kryetari i Degës zgjidhet në Kuvendin e Degës, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë, të cilët jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre në komunën në të cilën është organizuar Dega.

26.2 Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend të Degës. Kandidatura miratohet me 50 për qind plus 1 të delegatëve të pranishëm.

26.3 Kryetari i Degës është kryetar i Kuvendit të Degës dhe i Kryesisë së Degës.

26.4 Kryetari i Degës:

- Përfaqëson degën në pajtim me Statutin dhe Programin e KNRP-së;
- Thërret Kuvendin e Degës;
- Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë së Degës;
- Kujdeset për zbatimin vendimeve të Kuvendit të Degës;
- Emëron udhëheqës të fushave të ndryshme të aktivitetit të KNRP-së;
- I propozon Kuvendit kandidatët për anëtarë të Kryesisë, kurse Kuvendi ka të drejtë të shtojë edhe 1/3 (një të tretën) e kandidatëve për Kryesi;
- I propozon Kryesisë kandidatët për nënkryetar dhe sekretar të KNRP-së;
- Bashkërendit punën me nëndegët;
- Kryen edhe punë të tjera, që dalin nga organet më të larta të KNRP-së.

## **Kryesia e Degës**

## **Neni 27**

27.1 Kryesia e Degës është organ politiko-ekzekutiv i Kuvendit të Degës dhe përgjigjet për realizimin dhe zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Degës, si dhe të organeve më të larta të KNRP-së.

27.2 Numri i anëtarëve të Kryesisë së Degës përcaktohet me vendim të veçantë të Kryesisë së KNRP-së, për degët me numër më të vogël të anëtarësisë dhe për degët me numër më të madh të anëtarësisë.

27.3 Anëtarë të Kryesisë së Degës janë edhe kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë.

#### 27.4 Kryesia e Degës:

- Bashkërenditë punën e nëndegëve;
- Vendos për planin vjetor financiar të degës;
- Vendos për listën e kandidatëve për këshilltarë të Asamblesë Komunale;
- Propozon kandidatët për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga territori i saj;
- Me propozim të Kryetarit të Degës, zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Degës;
- Nxjerr rregulloret në nivel të Degës, në harmoni me Statutin e KNRP-së;
- Bashkërenditë, përcjell, analizon dhe përkrah aktivitetin e nëndegëve në terren;
- Kujdeset për organizimin e zgjedhjeve partiake, zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme.

### **Nëndega**

#### **Neni 28**

28.1 Nëndega formohet në territorin e një apo më shumë fshatrave, respektivisht lagjeve të qytetit.

28.2 Organet e nëndegës së KNRP-së janë Kuvendi dhe Kryesia.

28.3 Kuvendi i Nëndegës zgjedh Kryetarin, Kryesinë e Nëndegës dhe delegatët për Kuvendin e Degës.

28.4 Numri i delegatëve të Kuvendit të nëndegës caktohet varësisht prej numrit të anëtarëve të KNRP-së në nëndegë. Në të njëjtën mënyrë caktohet edhe numri i anëtarëve të Kryesisë së Nëndegës, por jo më shumë se 3 .

28.5 Përfaqësimi i nëndegëve në Kuvendin e Degës bëhet me vendim të Kryesisë së Degës, në bazë të kritereve të numrit të anëtarësisë.

28.6 Nëndega ka kryesinë e saj, e cila zbaton vendimet e degës dhe të organeve më të larta të KNRP-së.

28.7 Kryesia e Nëndegës zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Kryesisë së Nëndegës.

### **Financimi i KNRP-së**

#### **Neni 29**

29.1 Burimet e financimit të KNRP-së janë:

- Burimet publike - mjetet nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- Burimet nga anëtarësia dhe donacionet e personave fizik dhe bizneseve.

29.2 KNRP-ja ka Zyrtarin Financiar, të cilin e propozon Krytari i KNRP-se ndersa e emron apo zgjedh Keshilli I Pergjithshem dhe i përgjigjet drejtpërsëdrejti atij.

29.3 Zyrtari Financiar është përgjegjës për:

- Përgatitjen dhe ekzekutimin e planeve financiare (buxhetit);

- Hartimin e raporteve financiare dhe raportimin para institucioneve të parapara me ligj.

29.4 Kryesia në pajtim me Kuvendin e KNRP-së, cakton lartësinë e pagesës së anëtarësisë për çdo vit kalendarik, si dhe destinimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

29.5 Kryesia e KNRP-së, çdo vit, cakton shumën e mjeteve të cilat u barten degëve, sipas kriterëve të cilat rregullohen me rregullore të veçantë.

29.6 Për mjetet financiare të KNRP-së dhe shfrytëzimin e tyre, Kryesia i raporton Keshillit të Përgjithshëm të KNRP-se çdo vit.

## **MANDATI I ORGANEVE TË ZGJEDHURA, AKTET THEMELORE DHE KUSHTET NË TË CILAT PUSHON SË EKZISTUARI KNRP-ja**

### **Neni 30**

30.1 Mandati i anëtarëve të organeve të zgjedhura të KNRP-së është 4 (katër) vjet.

30.2 Shkarkimi i anëtarëve të zgjedhur të organeve të KNRP-së bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse janë zgjedhur.

30.3 Anëtarët e organeve të zgjedhura të KNRP-së, të cilëve u grumbullohen më shumë pozita partiake apo partiake dhe parlamentare (qendrore ose lokale), duhet të tregojnë gatishmëri për t'u tërhequr nga pozitat, të cilat ata nuk mund t'i ushtrojnë siç e kërkon interesi i KNRP-së ose pozitat të cilat paraqesin konflikt interesi.

30.4 Nëse anëtarët e organeve të KNRP-së nuk paraqesin gatishmëri për të hequr dorë nga pozitat e shumëfishta, atëherë iniciativën e merr Keshilli i Përgjithshëm i KNRP-së, kryesitë dhe kryetarët e degëve

30.5 Çështja e posteve të shumëfishta dhe konflikti i interesit rregullohen me rregullore të veçantë.

### **Neni 31**

31.1 Akti themelor i KNRP-se është Statuti i KNRP-së.

### **Neni 32**

32.1 KNRP-ja mund të pushojë së ekzistuari nëse për këtë vendosin  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) e të gjithë delegatëve në mbledhjen e rregullt apo të jashtëzakonshme të Kuvendit të KNRP-së.

## **SHPERNDARJA DHE TRASHEGIMIA**

### **Neni 33**

33.1 Në raste të shpërndarjes të KNRP-së përgjegjës për të gjitha borxhet e mbetura i mer kryetari dhe anëtarët e KNRP-së, ndërsa pasuria e mbetur do të kalojë në organizatat humanitare ROME.

## **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 34**

34.1 Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës për nxjerrjen e tij.

34.2 Nismën për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit mund ta japë Kuvendi i KNRP-së, Kryetari dhe Kryesia e KNRP-së.

34.3 Ndryshimet dhe plotësimet në organet e KNRP-së ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore, të bazuara në Programin Politik të KNRP-së, mund të bëhen edhe me votim të hapur. Vendimi për votim të hapur merret me së paku 50 për qind plus një votë të anëtarëve të organit përkatës

### **Neni 35**

35.1 Interpretimin autentik të këtij Statuti e bën Kuvendi i KNRP-së.

35.2 Tekstin e spastruar të Statutit dhe aktet e tjera të KNRP-së i ruan Sekretari Gjeneral.

### **Neni 36**

36.1 Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i KNRP-së.

36.2 Të gjitha aktet e cekura në këtë Statut duhet të miratohen brenda periudhës prej 180 ditëve, pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.